

NJOFTIM PËR MEDIA

Sot, më datë 04.09.2025, ora 10:00, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, Kërkesëpadinë Nr.30 Regjistri Themeltar Dt.01.09.2025 Regjistrimi, me:

PADITËS: Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” (PD-ASHM), përfaqësuar nga Z.Franci Nuri.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga Znj.Pavlina Doçaj.

PERSON I TRETË: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z.Eridian Salianji.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr.34, datë 28.08.2025 të Komisionit Rregullator pranë KQZ¹, duke vendosur rrëzimin e propozimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

BAZA LIGJORE: Neni 3, 8, 19, pika 1, 21, pika 1, gërma “a”, neni 20, pika 2, shkronja “d” e 3, neni 25, 25/1, 25/2, 26 pika 2, neni 39, pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 121, 123, 123/1, 123/2, 123/3, 124, 125, 127, 133, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 145, 152, 153, 155, 160, 161 si dhe neni 167 e vijues të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çështja u shqyrtua në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

1. Lutfije Celami (Relatore);
2. Entela Shedula (Anëtare);
3. Alma Kodraliu (Anëtare);
4. Ornela Naqellari (Anëtare);
5. Enkel Peza (Anëtar).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin Nr.30 Dt.04.09.2025, me shumicë votash:

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesë padisë.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

Tiranë, më 04.09.2025

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

¹Komisioni Rregullator pranë KQZ, me Vendim Nr.34 Dt.28.08.2025, objekt i kërkesëpadisë, ka vendosur:

“1. Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, si më poshtë vijon:

- a) Numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve për çdo subjekt zgjedhor, për çdo zonë zgjedhore sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve për çdo subjekt zgjedhor në rang vendi sipas lidhjes nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij”.